VENDIM
Nr. 395, datë 9.6.2022

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, si më poshtë vijon:
- znj. Delina Ibrahimaj kryetar;
- znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- znj. Inida Methoxha anëtare;
- znj. Brikena Qela anëtare;
- z. Ahmet Mançellari anëtar.

2. Trajtimi financiar i anëtarëve të Komisionit të Ndihmës Shtetërore bëhet sipas vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore", të ndryshuar.

3. Vendimi nr. 225, datë 26.4.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Ndihmës Shtetërore", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama